

Vendim nr. 118 datë 31.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 31.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ËNGJËLLUSHE REXHA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3568 (389), datë 17.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Ëngjëllushe Rexha është një ndër trashëgimtarët testamentare të trashëgimlënësit M.Rexha (babai i saj), duke trashëguar 1/3-n pjesë të pasurisë trashëgimore.

Kërkuesja ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës (ZVRPP) për të regjistruar Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. 248, datë 28.05.2000 të Komisionit të Ndarjes së Tokës dhe për t'u pajisur me certifikatë pronësie për një tokë bujqësore të llojit ullishte me sipërfaqe 75.000 m² të ndodhur në Kallm, Katundi Spitallë, Durrës. ZVRPP-ja, Durrës me aktverifikimin e datës 28.07.2007 i ka kthyer përgjigje se gjatë kontrollit kanë dalë disa probleme juridike, pasi kjo pasuri figuron shtet dhe duhet të aplikohet për regjistrimin fillestar, si dhe disa probleme hartografike në lidhje me planin e rlevimit, aktin origjinal të marrjes së tokës dhe formularin nr. 6 të konfirmuar nga qarku.

2. Në këto rrethana, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi, duke pretenduar se ZVRPP-ja, Durrës ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 3950, datë 30.12.2008, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Detyrimin e ZVRPP, Durrës të regjistrojë pronën me sipërfaqe 75,000 m² marrë sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 248, datë 25.08.2000, të ndodhur në Kallm Durrës, zona kadastrale 1574, e shtrirë pjesërisht në pasurinë nr. 145/2 dhe pasurinë nr. 276/1. Detyrimin e palës së paditur ZVRPP Durrës të pajisë me certifikatë pronësie mbi bazën e aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 248, datë 25.08.2000 për pronën 75,000 m² ndodhur në Kallm Durrës, zona kadastrale nr.1574. Ligjërimin e masës sigurimit të padisë vendosur me vendimin nr.23, datë 31.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me të cilën është urdhëruar pala e paditur ZVRPP Durrës të mos kryejë asnjë veprim në lidhje me sipërfaqen e tokës prej 75,000 m², e ndodhur në Kallm Durrës, zona kadastrale nr.1574 [...]”*.

3. Kundër vendimit nr. 3950, datë 30.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur ankim Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës (ZQRPP), e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, si dhe kundërankim kërkuesja. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2012-993 (497), datë 19.06.2012, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 3950, datë 30.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sa i takon: Detyrimin e ZVRPP, Durrës të regjistrojë pronën me sipërfaqe 75,000 m² sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 248, datë 25.08.2000 të ndodhur në Kallm Durrës. Detyrimin e palës së paditur ZVRPP, Durrës të pajisë me certifikatë pronësie mbi bazë të këtij regjistrimi. Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë. Prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit për pjesët e tjera.”*

4. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar çështjen, me vendimin

nr. 659, datë 09.12.2014, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 10-2012-993 (497), datë 19.06.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.”*.

5. Kërkuesja në datën 02.10.2015 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 659, datë 09.12.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 143, datë 03.11.2015, ka vendosur moskalimin e çështjes për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

6. Ndërkohë, pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2703, datë 29.06.2018, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 3950, datë 30.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”*.

7. Kundër vendimit nr. 2703, datë 29.06.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3568 (389), datë 17.11.2022 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2703, datë 29.06.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po aty, por me tjetër trup gjykues.

8. Kërkuesja në datën 14.04.2023 është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3568 (389), datë 17.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë janë cenuar:

9.1. *Parimi i gjykimit të drejtë dhe i disponibilitetit të padisë*, pasi gjykata, duke arsyetuar për vlefshmërinë e AMTP-së, ka tejkaluar objektin e padisë të përcaktuar nga kërkuesja.

9.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi nuk ka arsyetim ligjor dhe është kontradiktor. Gjykata ka arsyetuar në kundërshtim me dokumentet e ndodhura në dosjen gjyqësore.

9.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi AMTP-ja është një akt ligjor që njeh të drejtën e pronësisë prej 23 vjetësh dhe në bazë të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e

proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” është i detyrueshëm për zbatim.

9.4. *E drejta e pronësisë*, pasi Agjencia e Trajtimit të Pronës ka detyrimin ligjor për të regjistruar AMTP-në dhe nuk kryen asnjë veprim që nga viti 2000, kur ka dalë akti.

9.5. *E drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi është regjistruar në datën 26.07.2018, ndërsa vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i datës 17.11.2022.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Individi, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimimi i kërkueses, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae* Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin

përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron ajo, përfshirë edhe rastet e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata zhvillon gjykimin përfundimtar të ankesave të individit, që nënkupton se çdo individ legjitimohet në ankimin kushtetues individual kundër një vendimi gjyqësor, me kusht që procesi gjyqësor i shqyrtimit të themelit të çështjes të jetë përfunduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet kur mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës, duke parashtruar dy kërtime në përmbajtjen e kërkesës. Kërkimi i parë lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3568 (389), datë 17.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2703, datë 29.06.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po aty, por me tjetër trup gjykues. Ndërsa kërkimi i dytë lidhet me konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

17. Në lidhje me kërkimin e parë, Kolegji thekson se Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, i cili përcakton natyrën “përfundimtare” të gjykimit kushtetues, si rregull, individ mund t’i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë situatë, për të vlerësuar përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, merr rëndësi të përcaktohet nëse vendimi i kundërshtuar nga kërkesja në ankimin e saj ka formë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Objekti i ankimit kushtetues individual në rastin konkret lidhet me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2703, datë 29.06.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po aty por me tjetër trup gjykues.

18. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se meqenëse gjykimi i çështjes që i përket kërkeses është në proces dhe i papërfunduar, për sa kohë që çështja është në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, kërkesja nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike efektive për mbrojtjen e interesave pranë atyre gjykatave, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

19. Në lidhje me kërkimin e dytë, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, vlen të theksohet se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t’i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që gjatë shqyrtimit të rekursit të paraqitur në datën 26.07.2018, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, kërkesja të ketë përdorur mjetet

ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, për rrjedhojë ajo nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Në këtë situatë, kërkuesja ka ende mjete juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet gjykit kushtetues edhe për pretendimin e cenimit të kësaj të drejte.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.